



## **Federata e Para Boccia të Kosovës**

Në bazë të statutit të Federata e Para Boccia të Kosovës, Bordi i Federatës së Para Boccia të Kosovës, me datë 22.05.2025 miraton këtë:

### **RREGULLORE PËR ANTI-DOPING**

#### **Neni 1** Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim parandalimin, identifikimin dhe ndëshkimin e përdorimit të substancave dhe metodave të ndaluara në sportin e boccia, në mënyrë që të garantojë garë të drejtë, shëndetin e sportistëve dhe integritetin e sportit.

#### **Neni 2** Fusha e Zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha palët e përfshira në aktivitetet sportive të boccia në Kosovë, përfshirë sportistët, trajnerët, stafit mbështetës, zyrtarët dhe organizatorët e garave.

#### **Neni 3** Parimet Bazë

- Respektimi i Kodit Botëror Anti-Doping (WADA).
- Përgjegjësia individuale e sportistëve për çdo substancë që futet në trupin e tyre.
- Ndalimi i përdorimit të substancave dhe metodave të listuara në Listën e Substancave të Ndalura nga WADA dhe BISFED.

#### **Neni 4** Lista e Substancave dhe Metodave të Ndalura

Lista përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:

- Steroidët anabolikë.
- Hormonet dhe modifikuesit e tyre (përfshirë EPO-në).
- Stimulentët e caktuar.
- Diuretikët dhe agentët maskues.
- Metodatat e manipulimit të gjakut dhe mostrat biologjike.

### **Neni 5**

#### Kontrolli Anti-Doping

- Kontrolli mund të bëhet në çdo kohë para, gjatë ose pas garave.
- Sportistët duhet të bashkëpunojnë në mënyrë të plotë gjatë marrjes së mostrave.
- Mostrat merren nga personel i autorizuar sipas procedurave ndërkombëtare.
- Mostrat analizohen në laboratorë të akredituar.

### **Neni 6**

#### Të Drejtat dhe Detyrat e Sportistëve

- Sportistët kanë të drejtë të informohen për procedurat anti-doping.
- Duhet të paraqesin informacione të sakta për vendndodhjen për testime jashtë gare.
- Mund të kërkojnë analizën e mostrës "B" në rast të rezultatit pozitiv.
- Duhet të njoftojnë në rast të përdorimit të medikamenteve me përmbajtje të substancave të ndaluara, përmes procedurës së lejes së përdorimit terapeutik (TUE).

### **Neni 7**

#### Shkeljet dhe Masat Disiplinore

- Rezultatet pozitive sjellin pezullim të menjëhershëm.
- Pezullimi mund të jetë nga disa muaj deri në disa vite, në varësi të llojit të shkeljes.
- Dënimet mund të përfshijnë ndalimin e pjesëmarrjes në gara, humbjen e medaljeve, ose ndëshkime të tjera administrative.

**Neni 8**  
Procedurat e Apelimit

- Sportistët kanë të drejtë të apelojnë vendimet në organet përkatëse të Federatës.
- Apelimet duhet të paraqiten brenda afateve të përcaktuara (zakonisht 21 ditë nga njoftimi i vendimit).
- Komisioni i Apelit shqyrton rastin dhe merr vendim përfundimtar.

**Neni 9**  
Edukimi dhe Parandalimi

- Federata angazhohet në programe edukimi për sportistët, trajnerët dhe personelin mbështetës për rreziqet e dopingut.
- Promovimi i sportit të pastër dhe respektimi i etikës sportive.

**Neni 10**  
Dispozita Përfundimtare

- Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Bordi i Federatës.
- Ndryshimet dhe plotësimet bëhen me miratim zyrtar.
- Në rast mosmarrëveshjes, zbatohen udhëzimet e BISFED dhe Kodit Botëror Anti-Doping.

**Neni 11**  
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi Ekzekutiv i FPBOK-së.
2. Çdo rast i pa parashikuar nga kjo rregullore do të trajtohet sipas rregullave të përgjithshme të BISFED dhe vendimeve të federatës.

Kryetari i FPBOK-së

Murat Murati

---

Prishtinë, 22.05.2025